

**ALEXANDRE ZOTOS**

**DRITËRO AGOLLI, PRËTRE DE DIONYSOS – DRITËRO AGOLLI  
NËN MBRETËRINË E DIONISIT**

Krejtësisht e hapur ndaj zërave të botës, vepra poetike e Agollit shpaloset, në fazat e saj të njëpasnjëshme – me të drejtë – si një rapsodi ose simfoni e papërfunduar, ndaj harmonive tipikisht shqiptare, por me rezonanca universale. Përmbledhje pas përmbledhjesh, përtej synimeve të veçanta të secilës, ajo (vepra) zgjon tek njeriu mbretin e krijimit, por një mbret bashkëveprues me të gjitha forcat dhe jetët që përbëjnë mbretërinë e tij. Në këtë aspekt, mund të themi se vepra vendoset nën shenjë e Dionisit.

Analiza e këtij shpirti dionisiak, në kuptimin e gjerë të fjalës, inventari i shkaqeve dhe pasojave do të na çojë drejt përcaktimit se sa zbulon kjo poezi prej artit të shkruarit të poetit, por gjithashtu dhe për vetë qenien e mënyrën e tij të jetuarit, aq shumë Dritëroi njeri shfaqet në ato që shkruan. Kjo qasje synon pra, për ta thënë me terma më konkretë, të përvijojë dhe të ilustrojë modalitetet e këtij lirizmi sinonim të dinamizmit karakteristik të Dritëro Agollit, ku butësia virgjiliane ndeshet me energjinë mashkullore, dhembshuria me humorin, emocioni me shpirtin e lojës, thënë ndryshe rrugët përmes të cilave poeti ecën duke endur bëmat gjatë trajektores së ekzistencës së tij.

Le të fillohet, nisur prej këtij shpirti dionisiak që merr kuptim, me temën më të hershme tek ai, atë të fëmijërisë, temë në vetvete aspak origjinale, por që vendos dhe personalizon një pasojë gati konstante me atë retrospektive, të origjinës – kuptuar në sensin poetik po aq sa dhe gjenetik – dhe atë perspektiv, të së ardhmes. Sepse, në qoftë se Agolli priret ndonjëherë nga nostalgjia, lidhja e tij me të parët, nuk ngatërrohet aspak me një braktisje në avazet e njeriut që shijon të shkuarën, që ndien keqardhje për kohën e artë.

***E shkuara e së ardhmes, ose fjala e të urtit***

Shpirti fëmijnor merr pjesë në një memorje (kujtesë) të vetvetes, të pashkëputur prej një kujtese familjare dhe kombëtare, të një kulture të aktualizuar dhe të kthyer drejt së ardhmes, larg të qenit një kënaqësi e thjeshtë egoiste apo narcistike. Këtë e provon, mes shumë shembujsh të tjerë, *Kori i gurëve*, ku poeti shkruan duke evokuar disa heronj të ciklit epik të kreshnikëve:

*Kuvendimi i gurëve*

Gurë dhe gurë e nën gurët rrjedh uji

Nën gurët tulitet furtuna,  
 Nën gurët ofshajnë Halili e Muji.  
 Nën gurët vajton me ligje Ajkuna. – *Lypësi i kohës*

Përsa i takon referencës ndaj së ardhmes mjafton të citohet poezia  
*Fëmijët*

Mos u përpiqni t’u jepni fëmijëve mendjen tuaj,  
 As trupin tuaj mos u mundoni t’u jepni,  
 As buzëqeshjen e shtirë e të huaj.

Shëmtimet e mendjes dhe trupit tuaj u provuan,  
 Ndaj lërinini fëmijët këto gjëra vetë t’i gjejnë  
 Në dhomat e së ardhmes siç duan... – *Pelegriini i vonuar*

Trashëgimia e të parëve ushqen, mbështet mjaft të tashmen, ide që e insinuojnë më qartë akoma poemat *Bulkthi*, *Zërat e fjetur*, *Guri ose Çatia e vjetër*: vendlindja është ajo ku kemi burimin, ku, duke prekur tokën, rimarrim forcat e gjallërinë, ashtu si Anteu. Kështu në poezinë e parë në radhë, *Bulkthi*, kujtimet e fëmijërisë gjenden të bashkëlidhura me poezinë e vjetër popullore, edhe ajo shoqëruese e drejtpërdrejtë me punët e përditshme, ose e lindur prej këtyre punëve.

### *Bulkthi*

“Kri-kri” e tij më merr me vete mua,  
 Më merr të vockël, ndofta pa përmasa,  
 Më shpie ku lopa milet në katua  
 Apo ku thahen kumbullat në dërrasa.

Ky këngëtar sekret që s’duket kurrë  
 M’i mpleks e m’i përzjen të gjitha vitet,  
 Më hedh atje ku gjyshërit gdhendën gurë  
 Dhe mureve me anth murosën mithet... *Lypësi i kohës*

Të një efekti të ngjashëm janë zërat e atyre që s’janë më, por flenë në kujtimet e poetit, jo pa ndihmuar frymëzimin e tij, pa stimuluar vrullin e tij krijues.

Edhe këtu mbizotëron perspektiva e një të ardhmeje, jo e një shpirti të mbyllur e të veçuar në nostalgjinë e tij. Më mizore se lamtumira ndaj të vdekurve është lamtumira ndaj të gjallëve, na siguron poeti.

Asnjë dyshim: jeta do të ketë gjithmonë përparësi mbi vdekjen, duke theksuar më shumë të ardhmen se të shkuarën. Të vdekurit, që kanë bërë të shkuarën dhe janë vetë kjo e shkuar, frymëzojnë të tashmen dhe përgatisin të ardhmen. Janë ata që në botën ku është rritur D. Agolli, përmes shembullit e përvojës të tyre mësojnë jetën, në planin individual dhe social, po gjithashtu dhe dashurinë e jetës natyrore që na rrethon, me të cilën na lidh reciprociteti. Këtë lidhje kujton dhe dëshmon poema *Dëbora*. Kështu kremton jetën, në të gjitha aspektet dhe shkallët e saj. Sepse jeta nuk kufizohet vetëm me dehjet dhe vrullet që ekzaltojnë poemat si *Peizazhi i rrugës*, *Peizazhi i pyllit të zgjuar*, ose *Pulëbardha*, jo më pak domethënëse është ngazëllimi që provon kur kap, merr nga jeta, në vende dhe momente ku ajo duket sikur mungon apo është shuar. Të qenit bir i tokës dhe gazetar reportazhi prej shume vitesh, e bën të aftë ta shohë e ta njohë jetën, deri në format më të holla, më të dobëta, përtej heshtjes apo inercisë së jashtme të gjërave.

### *Nga jeta sekrete, në jetën e hapur*

Më shumë se një poezi ilustron këtë element çelës të përbërësës së tij afektive dhe mendore, nisur nga frymëzimi i tij poetik. Kështu, tek *Kuvendimi i gurëve*, përmendur dhe më parë, por në një tjetër këndvështrim, dhe tek *Bulkthi*, ai na bën të kuvendojmë me këto zëra dhe këtë muzikë sekrete që e bëjnë më të thellë e më të dendur heshtjen, vendin e një gumëzhime (britme) shurdhuese!

Gurë dhe gurë dhe guri pas gurit...  
Mendoni se heshtin e s'flasin?  
Mbrëmjeve pakëz afrojuni murit:  
Gurët në mur kuvendojnë e vikasin.

Poeti që dëgjon *Gjuhën e shpezëve* dhe zgjimin e zhurmshëm të *Pyllit të mëngjesit*, nuk zbulon më pak metamorfozat e lëvizjet e ngadalta që ndodhin rreth nesh, si në rastin e *Vizatimi i hijeve* apo *Qetësia*.

### *Qetësia*

Sythi s' dëgjohe kur del nëpër pemë, del qetësisht;  
Molla s' dëgjohe kur skuqet në degë, skuq qetësisht.

Gruri s' dëgjohe kur mbin nëpër arë, mbin qetësisht;  
Drita s' dëgjohe kur vjen në dritare, vjen qetësisht.

Nata s' dëgjohe kur zbret nëpër male, zbret qetësisht;

Jeta s' dëgjohej kur humb dalëngadalë, humb qetësisht.

Shembull tjetër të kësaj vëmendjeje për jetën okulte apo të fshehur, gjejmë në poezinë *Në kënetë*.

Tek fle nën bark e gudulisin peshqit  
Dhe duket sikur qesh një qenie e trashë.  
Të shëmbëllen nga larg si leshi i qelqit,  
Ndërsa nga afër zjen si truri i kafshës.

Në bark miliona jetë i bëri torfë,  
Miliona jetë u lindën dhe jetojnë,  
Ndaj truri i saj, megjithse i amorftë,  
Lëviz dhe shpesh trazon dhe gjumin tonë.

Një tjetër surprizë, ose ndryshe një tjetër mrekulli të vogël, nëse dimë të shohim mirë, pas një fenomeni tejet të zakonshëm na tregon poeti, në poezinë *Dita*. Një lindje njëherësh progresive dhe e pasigurt, e perezistueshme dhe e papritur, një triumf i jetës, fakti meteorologjik që kthehet pa rënë në sy e me delikatesë, menjëherë në parabolë:

*Dita*

Në fillim e imët, si degë panje e lagur,  
Vjen dita e brishtë, e mekët, e zbehtë,  
Vështron në dritare, kalon e drojtur pragan,  
E dobët, e mitur, e lehtë.

Dhe ti mendon: a mund të përkëmbet,  
A mund të rritet një gjë kaq e gjorë?  
Ndërsa ti mendon, mugëtira rreth teje shëmbet  
Dhe dita e merr pushtetin në dorë.

### ***Nga ndjenja në filozofinë e jetës ose vitalizmin e Agollit***

Kretimeet e *Peizazhit të pyllit të zgjuar* apo *Gjuhës së shpezëve*, tejkalojnë dhe vetë euforinë fizike: këto 2 poezi kanë si elemente shkrirjen mes artit të jetuarit dhe artit të shkruarit, emocionet dhe përshtypjet e jetuara thërresin fjalët e frymëzuara që, reciprokisht u shtojnë forcën dhe i kristalizojnë.

Ligji i plotfuqishëm i botës, i provuar, ilustruar – në të njëjtën kohë që rikrijohet përmes fuqisë së fjalëve – bën që gjithçka, në sytë e Agollit, të ekuilibrohet, të pajtohet, përtej konflikteve dhe divergjencave: bashkekzistenca e të kundërtave bëhet e mundshme, deri dhe e dobishme. Nuk ka për të antinomi, ndarje mes të mëparshmes dhe të tanishmes, të tanishmes dhe të mëpastajmes, mes të palëvizshmes dhe asaj që lëviz: ai nuk përjashton asgjë, nuk refuzon, përveçse ngurtësisë së vdekjes, asaj palëvizshmërie që përfshin dhe ngrin të gjallin (qoftë dhe në formën e njeriut të lirë, anarkik), ai nuk kundërshton ndryshimin, përveç rastit kur vjen nga një pabesi, një mohim, dhe jo nga një inovacion.

B. Kuçuku, në antologjinë e pasur që ia ka kushtuar poetit, nuk ka lënë pa vënë në dukje mbizotërimin e ecjes dhe të lëvizjes si figura mbizotëruese në imagjinaren e tij. Dhe këtu qëndron fuqia e jetës, në opozicion me inercinë, si shenjë dhe pasojë e dukshme e çdo vdekjeje. Mund të themi se një lojë kundërpeshë realizohet nga poeti, sepse referenca simbolike të asaj që është e qëndrueshme, permanente, e paprekshme janë gjithashtu: toka, pema, guri... duke pasur parasysh se qëndrueshmëria dhe vazhdimësia, në sytë e poetit nuk rimojnë aspak me palëvizshmërinë dhe ngurtësimin.

Kështu dalim më në fund, në moralin antik të *naturam sequi*, parim që nënkupton një thelb optimizmi, një besim në mirësinë e lindur prej kësaj natyre, por optimizëm aspak mbushur plot kënaqësi tek Agolli, për të cilin jeta ka jo pak armiq. Është pikërisht ky besim i vazhdueshëm në jetën që tradhton, në jehonën e saj të dyfishtë, një poezi si *Peizazh asfalti*: në qoftë se asfalti uniformizon, fshin rendin natyral dhe morinë e gjërave, kjo nuk ndodh pa asnjë përfitim sipas vështrimit të buzëqeshur dhe prodhimtar të poetit: çfarë pasqyre të bukur, të lëmuar prej shiut dhe diellit gjejnë aty vajzat lule.

Më i fortë e në të njëjtën kohë më i gjetur ndoshta, është implikimi i dyfishtë i poezisë *Pulëbardha*. Poeti rimerr aty temën e fabulës së La Fontenit *Ujku dhe qëngji*, po jo pa e pasuruar me një sugjestion që e bën pulëbardhën një krijesë më interesante për mendimin tim, se ujku i poetit francez, përballë qenit të zbutur, kjo sepse, nuk është aq thirrja e hapësirave të mëdha – sinonim i lirisë – që e ka bërë të braktisë dhomën ku jeton e mbyllur, që keqardhja për dallditë e dikurshme, sfidat dhe provat e elementeve të çliruara nga zinxhirët, shumë më ekzaltuese se kohët e qeta. Dhe ajo largohet, jo një ditë qetësie, por në një ditë stuhie. Shumë më tepër se humbja e lirisë, i peshonte mërzia e një jete shumë pasive dhe shumë të sigurt. Ajo ndihet e vdekur në rrezikun e munguar të burgut të praruar, nga ku u lindte një dëshirë gjithmonë e më e parezistueshme, për të përballuar shtrëngatën, për të provuar përsëri drithërimat e mëdha të rrezikut të çmendur, të atij që bën që jeta të prekë shkallën më të lartë të intensitetit.

***Mosha e njeriut ose koha e të jetuarit***

Pra tema e vdekjes – me të cilën lidhet tema e kohës dhe e plakjes – zë vetëm pak vend në poezinë e tij, siç kemi mundur të konstatojmë menjëherë, duke komentuar *Pesha e lotëve*: aq larg shkon perandoria e jetës, aq sovraane mbetet ajo, sa vdekja vetë, ndonjëherë shndërrohet në të kundërtën e vet. Le të lexojmë në mënyrë të veçantë *Le passage du temps (Kaluan vitet)*, këtë poemë të së shkuarës së tejkaluar, të kohës pjellore e të pllenuar, përtej tonit literal të titullit shqiptar (*Kaluan vitet*), sepse ai nuk të lë aspak ta parashikosh se “koha s’ka asnjë efekt”, sikundër thonë proverba dhe vargjet në vazhdim:

Kaluan vitet, – ke qëndruar  
E brishtë, e ashpër dhe peri,  
Veç flokët krejt të qenkan shtruar  
Dhe thinjët ndritën pakëz gri.

***Nga një botë e gjallë në një botë të poetizuar ose sivëllazëria e poetëve***

Krejt e shkuara s’është veçse një varg jetësh, një mbarsje e vazhdueshme me jetë të reja, trashëgimtarë të jetëve të mëparshme, dhe një muze nostalgjish që veçse i bën thirrje retrospektivës. Të pranëvëna, të dy antologjitë në fjalë, që pasqyrojnë disi besnikërisht tërësinë e shkrimeve në vargje të Agollit, paraqiten në përgjithësi si një tërësi psalmesh të një feje laike të jetës. Ato rrezatojnë një vitalitet, që sipas meje, afrohen me atë të shkrimtarit francez Maurice Genevoix, mjeshtrin e madh të Ujëra dhe Pyje të Francës, me Jean Giono, apostullin e Hyjit Pan, dhe me Jules Romains, priftin e unanimizmit (njëzëshmërisë).

Këto ngjashmëri, më duhet ta saktësoj këtu, nuk janë veçse rasti për të shprehur thjesht një kënaqësi letrare, për hir të kulturës sime të dyfishtë franceze dhe ballkanike: ato lejojnë të shihet më mirë se sa shumë njeriu, tek Agolli është solidar me kafshët e sendet, nga ku buron edhe fqinjëria, gjithashtu, me Francis Ponge ose me Eugène Guillevic dhe në këtë rast (solidariteti me gjërat), me Jules Renard në këtë rast (me kafshët).

Këto skica dhe piktura priren drejt një antropomorfizmi më imediat, ndoshta, dhe sidomos më euforik nëse e krahasojmë me Ponge ose me Guillevic, por që sidoqoftë nuk i fshin tablotë: gjithçka që merr pjesë në krijim konfirmohet në legjitimitetin e specifikën e vet. Këtu qëndron, mund të themi madje, shenja e fortë dhe dalluese e perceptimit të tij mbi botën dhe e kuptimit të jetës: në këtë bashkëfajësi dhe reciprocitet midis njeriut dhe mjedisit të vet, në këtë korrelacion dhe këtë marrëveshje midis rendeve të ndryshme përbërës të qëndrimit në tokë: njeriu, kafsha, bima dhe minerali – sipas një pranije që e ndajnë së bashku.

Me këto suaza krahasuese të vendosura kësisoj, duket interesante të vëmë përballë tekste ose pjesë tekstesh të autorëve francezë të lartpërmendur me ato të poetit shqiptar, përmbledhja e të cilit *Udhëtoj i menduar* (Le voyageur pensif) përmban një pjesë të tërë ku ai ecën në shoqëri të poetëve dhe ne, nga ana tjetër, i detyrohemi atij për përkthimin e Eluard, Burns, Ritsos dhe poetëve rusë të “shekullit të argjendtë”. Kur lexon poezi si Peshqit (*Les poissons*) dhe *Les canes*, apo Patat e egra (*Les oies sauvages*), Peizazhe me plepa (*Paysage avec peupliers*) ose Me shpatull pas pishës (*L'épaule contre un pin*), nuk mund të imagjinojmë një përkthyes më të mirë se ai vetë, për t'i ofruar publikut shqiptar *Histoires naturelles* të Jules Renard; le të gjykojmë nisur nga këto rreshta ku poeti francez po përtyr një pulëdëti:

Ajo tundet e shkundet në mes të oborrit, sikur të jetonte në regjimin e vjetër./[...] [...] Fryhet aq sa nuk i sheh dot më këmbët e saj / Ajo nuk dyshon për askënd dhe, sapo i afrohem, mendon se dua t'i shpreh nderimet e mia./ dhe nis e gurgullon [...]

Që nga majat e maleve të Shqipërisë, shikimi i Dritëroit kap tërë botën, edhe në kohë edhe në hapësirë, meqë meditimi shkon krah për krah me një vëmendje konstante për plasticitetin dhe rezonancën e skenave dhe tablove që formojnë, me bashkëjetesën e tyre, të gjithë banorët e planetit.

Pas këtyre leximeve e konsideratave të ndryshme, askush nuk mund ta vërë në diskutim, mendoj unë, titullin e shquar poet popullor, titull që nga ana tjetër, identifikohet me poet kombëtar, të cilin ai e ka fituar që me gjallje. Dhe poet popullor e meriton të jesh, kur mundesh si ai të pajtosh mënyrën ludike me atë lirike ose medituese dhe gjuhën e folur me atë të shkruar, një mënyrë e sigurt për të mbetur në kujtime, dhe më pas në kujtesën e një populli! Për më tepër, e ngulitur siç është në kohë e në botë, kjo poezi ka privilegjin e rrallë t'u flasë të gjithë lexuesve: poezi formuese dhe nistare për më të rinjtë, ajo prek po aq publikun e rritur përmes jehonës, në planin ekzistencial, që buron nga një eksperiencë jete aq e dendur e aq e përfshirë në atë çka ai shpreh botërisht. Dhe një mënyrë e sigurt, pra, për të thënë edhe një herë me një batutë në stilin e tij “për të demokratizuar” një zhanër letrar që është gjykuar më së shumti “oligarkik”.

Dhe në fakt, s'kishte si të ndodhte ndryshe, por ja që zor se e mendojmë që një poet aspiron – dhe ia arrin – të bëhet poeti i gjendjes sonë të rëndomtë dhe atdheut tokësor vetëm në emër dhe për të mirën e *happy few!* “Poet i tokës”, shkruante njëri prej përkthyesve dhe komentuesve (studiesve) të tij, me shumë simpati madje, por ta etiketosh kështu do të thotë t'ia ulësh vlerat. Asnjë autor shqiptar, në mos ballkanik, nuk e ka harmonizuar si ai njeriun

“kallam meditues” të Paskalit me kallamin e ndjeshëm e mërshor, dhe këtë “mbret të krijimit” me tërësinë e krijimit. Për Dritëro Agolli, bota ekziston, sigurisht, në secilën prej përbërësve të saj, dhe i vërteton si përgjigje, ekzistencën e saj. Ai e mirëpret këtë botë me larminë e teprinë e saj, me një galdim lakmues, të shkrirë me një dozë humori dhe shakaje. Përfundimisht, ai vetë, qëndron midis aspiratave ose prirjeve të ndryshme, d.m.th. të kundërta por jo kontradiktore, jo konfliktuale: alternohen dhe shkojnë krah për krah, nga një poemë në tjetër, ideali i rrënjosjes dhe ëndrra e Ikarit, humori nostalgjik dhe një etje e madhe për të jetuar, limontitë e të urtit plak dhe padurimi i neofitit të përjetshëm, shpotia dhe padjallëzia, dashuria për zhurmat dhe muzikën e botës, duke filluar nga ajo e fjalëve por edhe e heshtjes, Dritëroi solidar dhe më në fund edhe Dritëroi vetmitar.

Ta vësh poezinë e tij nën shenjën e Dionisit, pra, nuk është pa vend. Ky hyj është vërtet i tij, përderisa është hyj i verës dhe i vreshtit, simbol i jetës dhe i forcës, por edhe i dehjes të frymëzuar, për çka afirmohet dhe bashkëprinc legjitim i Parnasit. Dionisi është gjithashtu, hyji i teatrit, këtij arti kufi me poezinë, që nga etimologjia, të bën të shohësh dhe të dëgjosh fort, atë çka do dhe bën, gjithashtu, miku Dritëro, regjenti dhe administratori ynë i tokave të banuara, dhe besoj se kemi thënë mjaft në këtë udhëtim të shkurtër por të gjallë në universin e tij poetik, çka, në kuptimin literal gjithashtu, i jep një virtut vërtet ekumenik.

## Bibliografi

### Indeksi i titujve dhe i teksteve të cituara

- 1 - *Le cœur des pierres / Kuvendimi i gurëve*
- 2 - *Les enfants / Fëmijët*
- 3 - *Le Grillon / Bulkthi*
- 4 - *Les voix dormantes / Zërat e fjetur*
- 5 - *Le caillou / Guri*
- 6 - *Le vieux toit / Çatia e vjetër*
- 7 - *Le poids des larmes / Peshë e lotit*
- 8 - *La neige / Dëbora*
- 9 - *Paysage avec route / Peizazhi i rrugës*
- 10 - *Forêt matinale / Peizazhi i pyllit të zgjuar*
- 11 - *La mouette / Pulëbardha*
- 12 - *Le parler des volatiles / Gjuha e shpezëve*
- 13 - *Jeux d'ombres / Vizatimi i hijeve*
- 14 - *En douce / Qetësia*
- 15 - *Le marais / Në kënetë*

- 16 - *Le jour / Dita*  
 17 - *Les champignons / Kërpudhat*  
 18 - *Le moment de l'éclair / Peizazh pas shkrepëtimës*  
 19 - *Paysage asphalté / Peizazh asfalti*  
 20 - *L'Adieu au Kapédan / Lamtumirë, Kapedani im*  
 21 - *Un grondement de vents lointains / Zhurma e erërave të dikurshme*  
 22 - *Splendeur et décadence du camarade Zyló / Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyló*  
 23 - *La voix du vent / Kënga e erës*  
 24 - *Le passage du temps / Kaluan vitet*  
 25 - *Mes lettres d'amour / Mbarim rinie*  
 26 - *Mes rides / Në rrudhat e mia*  
 27 - *Les poissons / Peshqit*  
 28 - *Les canes / Rosat e buta*  
 29 - *Les oies sauvages / Patoku*  
 30 - *Paysage avec peupliers / Peizazh me plepa*  
 31 - *L'épaule contre un pin / Pranë pishës*  
 32 - *Le papillon de nuit / Flutura e natës*  
 33 - *La crête / Shkëmbi*

*Mesditë* (Le mitan du jour, 1969): texte 18

*Fjala gdhend gurin* (Les mots sculptent la pierre, 1977): texte 19, 33

*Udhëtoji i menduar* (Le voyageur pensif, 1985): textes 5, 8, 9, 10, 11, 12, 28, 31

*Pelegri i vonuar* (Le pèlerin attardé, 1993 et 1998): textes 2, 6, 14, 16, 23, 25

*Lypësi i kohës* (L'aumône du temps, 1995): textes 1, 3, 13, 27

*Vjen njeriu i çuditshëm* (Soudain l'homme singulier, 1996): textes 15, 24, 26, 29, 32

*Fletorka e mesnatës* (Cahier de nuit, 1998): textes 4, 7, 17, 30

Përktheu: **Laura Smaqi**

**RÉSUMÉ****DRITËRO AGOLLI, PRÊTRE DE DIONYSOS**

Tout entière ouverte sur la rumeur du monde, l'œuvre poétique de Dritëro Agolli se déploie, en ses phases successives, comme une rhapsodie ou symphonie inachevée – et pour cause – aux harmonies typiquement albanaises mais aux résonances universelles. Recueil après recueil et par-delà les visées particulières de chacun, elle exalte en l'homme le roi de la création, mais un roi complice de toutes les forces et vies constitutives de son royaume, et en cela elle se place, peut-on dire, sous le signe de Dionysos.

L'analyse de cet esprit dionysien, au sens large du terme, l'inventaire de ses tenants et aboutissants, nous amènera à définir ce que cette poésie révèle de l'art d'écrire du poète, mais aussi de son être même et de son art de vivre, tant l'homme est engagé dans ce qu'il écrit. Cette approche vise donc, pour le dire en termes plus concrets, à cerner et illustrer les modalités de ce lyrisme synonyme de dynamisme, propre à Dritëro Agolli, où la douceur virgilienne le dispute à l'énergie virile, la tendresse à l'humour, l'émotion à l'esprit ludique, soit les voies par lesquelles le poète va tissant la geste du séjour terrestre, de tout ce qui l'habite ou l'habille, au fil du trajet de sa propre existence.